

Luan TETAJ

**Themelimi i Kazermës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës -
Baran 1998**

Kushtet dhe rrethanat e fillimit të luftës së armatosur, si në Kosovë ashtu edhe në Rrafshin e Dukagjinit, ishin tejet të rënda dhe të pafavorshme. Mirëpo, ishte nevojë e domosdoshme për organizimi dhe fillimin e luftës së armatosur për çlirim. Në organizimin dhe fillimin e luftës së UÇK-së, në Rrafshin e Dukagjinit, padyshim që meritat më të mëdha i takojnë familjes Haradinaj në Gllogjan. Pas luftës së Prekazit dhe qëndresës heroike të Adem Jasharit, forcat policore dhe ushtarake serbe sulmuan Gllogjanin, më 24 mars të vitit 1998. Luftimet qenë të ashpra, forcat policore dhe ushtarake serbe nuk ia arritën qëllimin e dëshiruar dhe u detyruan të tërhiqen me humbje.

Sulmi në Gllogjan dhe qëndresa heroike e njësiteve të UÇK-së, pati jehonë të madhe në mbarë territorin e Rrafshit të Dukagjinit. Kjo ndikoi në ngritjen e moralit të popullsisë dhe masivizimin e UÇK-së. Mirëpo, edhe pse ekzistonte një dëshirë e madhe e rinisë për t'iu bashkëngjitur radhëve të UÇK-së, mungesa e armatimit e bënte të vështirë rekrutimin e tyre në radhët e UÇK-së. Për rekrutimin e të rinjve që dëshironin t'iu bashkoheshin radhëve të UÇK-së, nuk ekzistonin as kushtet minimale. Mungesa e armatimit, pamundësia e aftësive të përdorimit të armëve për shkak të mungesës së ekspertëve ushtarakë, e bënin gjendjen edhe më të vështirë.

Masivizimi i luftës së UÇK-së, u bë edhe më i madh në muajt maj-qershor të vitit 1998. Furnizimi me armatim bëhej me vështirësi të

madhe përmes Shqipërisë. Në këto rrethana shtohet nevoja e formimit të një qendre për stërvitjen e ushtarëve. Në fillim u formuan qendrat stërvitore nëpër fshatra. Në këto qendra individët e rekrutuar në radhët e UÇK-së, njiheshin me gjërat elementare të artit ushtarak (përdorimi i armëve, zgjidhja e pozicioneve luftarake, sulmi mbi pozicionet e armikut dhe tërheqja etj.).¹

Masivizimi i luftës dhe rritja në vazhdimësi e numrit të të rinjve të rekrutuar në radhët e UÇK-së, shtonë nevojën e formimit të një qendre më të madhe ushtarake. Idenë për formimin e një kazermë ushtarake e dhanë oficerët që kishin përfunduar akademinë ushtarake në ish-Jugosllavi, dhe kishin njohuri të mjaftueshme për organizimin dhe formimin e kazermës ushtarake, ku do të bëheshin stërvitjet dhe organizimi i luftës së tyre kundër forcave pushtuese serbe.

Gjendja ishte e rënd në terren, dhe ekspertët ushtarakë e panë të nevojshme që pas themelimit të kazermë “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan, të themelohej edhe kazermë e UÇK-së, në Baran. U mor vendim që kazermë të ngrihet në lokalet e shkollës në fshatit Baran. Në radhë të parë, fshati Baran ishte pikë më e përshtatshme strategjike, ku forcat ushtarake e policore serbe me vështirësi të madhe mund të depërtonin deri në brendësi të fshatit. Ky fshat shtrihet në luginën me emrin Lugu i Baranit, e në bazë të këtij vendbanimi tërë ajo trevë njihet si Lugu i Baranit. Fshati Baran shtrihet 14 km në juglindje të qytetit të Pejës. Barani njihet si vendbanim me dy mëhallë të ndara dhe merren si dy fshatra - Barani i Epërm dhe Barani i Poshtëm.²Në defterin e sanxhakut

¹ Krasniqi Din, *Ditari i Luftës*, 1998.

² Krasniqi, Mark, *Lugu i Baranit, Monografi etno-gjeografike*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Botime të veçanta, Libri IX, Seksioni i shkencave shoqërore, Libri 3, Prishtinë, 1984, f. 90.

të Shkodrës të vitit 1485, thuhej së Barani i Epërm varet nga Peja. Gjatë asaj kohe, Barani i Epërm kishte 21 shtëpi (kryefamiljarë).³

Në fillim kishte shumë vështirësi në organizimin e kazermës dhe furnizimin e saj me pajisje teknik, inventar etj. Kazerma e Baranit dita-ditës e merrte formën e një kazermë të organizuar dhe funksionale. Duke iu referuar “Ditarit të Luftës” së doktor Din Krasniqit, formimi i Brigadës 131 “Adrian Krasniqi”, u bë në fshatin Vranoc të komunës së Pejës, në koordinim me komandantin e Zonës Operative të Dukagjinit, z. Ramush Haradinaj.⁴ Brigada 131 ishte vendosur në kazermën e Baranit, komandant i saj ishte emëruar Rustem Berisha. Pastaj, komandën e kazermës e mori Nazif Ramabaja, sepse Rustem Berisha ishte përqendruar në luftimet që po zhvilloheshin kundër forcave policore dhe ushtarake serbe në bjeshkët e Junikut. Ishte e vështirë që fizikisht të lëvizej nga të dyja anët. Në kazermën e Baranit shumë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës morën leksione teorike dhe praktike. Pjesa më e madh e ushtarëve ishin papërvojë ushtarake dhe ndjekja e trajnimeve ishte më se e domosdoshme për vijimin e luftimeve që po zhvilloheshin në tërë Rrafshin e Dukagjinit.⁵

Kontribut të madh në themelimin dhe funksionalizimin e kazermës së Baranit ka dhënë Ramush Haradinaj, në koordinim edhe me grupin e oficerëve, si: Tahir Zemaj, Nazif Ramabaja, Rustem Tetaj, Musa Dragaj, Esat Shala etj. Nuk ishte e lehtë në gjendje lufte të

³ Pulaha, Selami, *Deferi i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, Akademia e Shkencave e RP. të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1974, f. 53.

⁴ Krasniqi, Din, *Ditari i Luftës 1998*; Adrian Krasniqi kishte rënë dëshmor në fshatin Kliqin, Lugu i Leshanit, gjatë luftimeve me forcat policore serbe në vitin 1997. Kazerma e Baranit e mori emrin e dëshmorit të kombit Adrian Krasniqi.

⁵ Arkivi i Brigadës 131 “Adrian Krasniqi” - Zona Operative e Dukagjinit, Baran, 1998.

bëhej një organizimi i mirëfilltë i kazermës, sepse vështirësitë ishin të natyrave të ndryshme. Leksionet në kazermë bëheshin nga njerëzit profesionist, si: Nazif Ramabaja, Esat Shala, Musa Dragaj etj., ndërsa ushtrimet praktike në terren bëheshin nga Isuf (Cufë) Krasniqi, Nazmi (Kapllan) Gashi etj. Eprorët e lartpërmendur me njësitet e tyre kanë marrë pjesë në shumë vija të frontit gjatë vitit 1998. Nga kjo kazermë dolën shumë ushtarë të përgatitur, të cilët u dëshmuar në shumë luftime në Zonën Operative të Dukagjinit.⁶

Kazerma e Baranit kishte mbështetje të madhe edhe nga fshatrat përreth saj. Doktor Din Krasniqi i kishte dhënë mbështetje të madhe komandantit të Brigadës 131 në Baran, duke i ofruar në ndihmë një numër të konsiderueshëm ushtarësh të fshatrave përreth. Po ashtu, furnizonte me gjëra ushqimore kazermën e Baranit. Kontributi i doktor Din Krasniqit ishte i madh, ku përveç ndihmës së tij në organizimin e UÇK-së në Lugun e Baranit, shquhet edhe për mjekimin dhe shërimin e shumë pjesëtarëve të UÇK-së, në Zonën Operative të Rrafshit të Dukagjinit, si mjekimin e fëmijëve, pleqve, grave etj. Gjatë vitit 1998, kontributi i doktor Din Krasniqit duhej vlerësuar, sepse ishin të rrallë mjekët e tillë, jo vetëm në Zonën Operative të Dukagjinit, por edhe në tërë Kosovën.⁷

Një kontribut modest kishte dhënë Imer (Sadri) Krasniqi nga fshati Vranoc, i cili në mënyrë vullnetare i punoi 20 kollare falas për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare në kazermën e Baranit. Në kazermën e Baranit ishin kushtet e rënda për të jetuar, sepse një pjesë e ushtarëve e bënin gjumin në dysheme dhe në dyshek nga sfungjeri. Iniciativa e tij është vlerësua shumë nga eprorët dhe nga pjesëtarët e UÇK-së. Po

⁶*Po aty.*

⁷ Din Krasniqi, *Ditari i Luftës 1998.*

ashtu, bëri rregullimin e një numri të madh të automatikëve-kallashnikovë që ishin të punuar nga kondaku i drurit. Këto armë u bënë më praktike dhe u hynin në punë pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare.⁸

Vlen të përmendet edhe kontributi i Nezir (Bajram) Krasniqit në përmirësimin e kushteve në kazermën e Baranit. Furnizimi me ujë në kazermën e Baranit bëhej me shumë vështirësi, por, falë punës së tij ky sistem u bë funksional. Numri i atyre që kanë kontribuar në themelimin dhe mbarëvajtjen e kazermës së Baranit është shumë i madh.⁹

Kazerma e themeluar në rrethana luftime në Rrafshin e Dukagjinit, kishte rëndësi të madhe në zhvillimin e luftës çlirimtare. Për herë të parë në historinë e Kosovës, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i morën leksionet ushtarake në gjuhën shqipe dhe u trajnuar në mënyrë profesionale për artin ushtarak.

Në vijim po ju sjellim bërthamën e Brigadës 131, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kazermën e Baranit: Rrustem Berisha, kishte mbetur në Jasiq; Agim Ramadani, mbetet në Jasiq; Astrit Ademaj, mbetet në Jasiq; Nazif Ramabaja-Kamenicë; Esat Ademaj-Raushiq; Shaban Draga-Drenicë; Din Krasniqi-Vranoc; Isuf (Cufë) Krasniqi-Vranoc etj.¹⁰

Njësitet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kazermën e Baranit morën pjesë në shumë beteja në Zonën Operative të Dukagjinit. Beteja e Loxhës ishte njëra ndër betejat më të rëndësishme të UÇK-së, jo vetëm në Zonën Operative të Dukagjinit, por edhe në tërë Kosovën. Në

⁸ *Po aty.*

⁹ *Po aty.*

¹⁰ Arkivi i Brigadës 131 “Adrian Krasniqi” - Zona Operative e Dukagjinit, Baran, 1998. Përpilues i listës, major Nazif Ramabaja, kazerma e Baranit - Zona Operative e Dukagjinit.

betejën e Loxhës, më 6 korrik të vitit 1998, kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë njësitit intervenues në krye me Nazif Ramabajën-eprror dhe komandant, Esat Ademaj-eprror, Faruk Xhemajli-eprror etj. Përveç njësiteve të rregullta të UÇK-së, nga kazerma e Prapaqanit dhe e Baranit në betejën e Loxhës kontribuan edhe luftëtarët nga fshatrat, si: Kodradiq, Vranoc, Buqan, Kosoriq, Çallapek, Jabllanicë, Barani i Epërm, Broliq, Strellc, Llukë e Ulët etj. Pas kërkesës për përforcime nga ana e Nazif Ramabajës u erdhën në ndihmë në betejën e Loxhës, Tahir Zemaj-komandant, Sali Qekaj-eprror, Fadil Hadergjonaj-eprror, Shaban Draga-eprror, Lumni Surdullie-eprror i vrarë në betejë, Farush Thaçi-eprror, Bajram Stojkaj-eprror, Rustem Bruqi-eprror i vrarë në betejë, si dhe një numër i madh i luftëtarëve të UÇK-së nga Zona Operative e Dukagjinit.¹¹

Në gusht dhe në shtator të vitit 1998, forcat policore dhe ushtarake serbe morën ofensivë të madhe në Zonën Operative të Dukagjinit, që deri në atë kohë nuk ishte parë në Kosovë. Gjatë asaj kohe, të gjitha vijat e luftimeve kishin nevojë për përforcime shtesë. Më 10 gusht 1998, Nazif Ramabaja kishte vajtur në Glllogjanin e Rekës për të vëzhguar më afër gjendjen pas ofensivës së madhe që kishin kryer forcat ushtarake dhe policore serbe. Në kontakt me komandantin e Zonës Operative të Dukagjinit, Ramush Haradinaj, i doli në ndihmë me një togë si përforcime në vijën e parë të frontit. Pas kthimit në kazermën e Baranit ai urdhëroi përgatitjen e një togu, duke zgjedhur ushtarët më të mirë dhe me përvojë. Emëroi komandantin e togut në krye me Isuf (Cufë) Krasniqi dhe tridhjetë ushtarë të njësitit për intervenime të shpejta. Njësitit i brigadës u nis për në Glllogjan të Rekës, dhe rreth mesditës komandanti i kazermës ishte informuar nga Ramush

¹¹*Po aty.*

Haradinaj, që njësitë i dërguar ka mbërritur dhe është sistemuar në vijën e parë të frontit, si mbështetje e forcave dhe zëvendësim të tyre. Më poshtë po sjellim emrat e njësitit intervenues për intervenime të shpejta në Gllogjan të Deçanit: Isuf (Cufë) Krasniqi-komandant i njësitit, Naim Kolica, Arben Komani, Blerim Sadrijaj, Ahmet Thaçi, Miftar Kelmendi, Xhavit Krasniqi, Egzon Gashi, Artan Berisha, Jahir Kastrati, Besim Shala, Bekim Morina (i plagosur), Artan Bezeraj (i plagosur), Asllan Krasniqi, Demë Shala, Rustem Krasniqi, Shefqet Gjoci (i plagosur), Fatmir Krasniqi, Ahmet Isufi (i plagosur), Bajram Muhaxheri, Afrim Morina, Ramush Ahmetaj, Qazim Gashi (i plagosur), Adem Bekaj, Xhevdet Gashi, Gani Berisha, Sefadin Berisha, Milazim Berisha, Albert Shala (i plagosur), Mentor Morina dhe Naim Zeqa.¹²

Pas Betejës së Loxhës të zhvilluar më 6 korrik 1998, dhe disfatës së ushtrisë dhe policisë serbe, paramilitarëve dhe mercenarëve serbë, të indinjuar për disfatë e pësuar, më 15 gusht të vitit 1998, u sulmua fshati Loxhë nga të gjitha anët, e duke e ditur nga përgjimet tona se është duke u përgatitur një sulm i tillë, njësitet e UÇK-së në kazermën e Baranit kishin bërë gati njësitin intervenues në krye me eprorin Esat Ademaj si komandant i njësitit për intervenime të shpejta në Loxhë.¹³

¹² Arkivi i Brigadës 131 “Adrian Krasniqi” - Zona Operative e Dukagjinit, Baran, 1998. Përpilues i listës, major Nazif Ramabaja, kazerma e Baranit - Zona Operative e Dukagjinit.

¹³ *Po aty.*

Betimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Baran 1998

Organizimi i betimit të ushtareve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kazermën e Baranit ishte shembull i mirë edhe për zonat tjera në Kosovë. Betimi i ushtarëve të UÇK-së, ishte organizuar në mënyrë profesionale. Organizimin dhe mbarëvajtja e kësaj ceremonie ushtarake kishte rëndësi të veçantë për zhvillimet e mëtejme të luftës çlirimtare në Rrafshin e Dukagjinit. Të gjitha veprimet e kësaj ceremonie ushtarake ishin të koordinuar edhe më komandantin e Zonës Operative të Dukagjinit, z. Ramush Haradinaj.¹⁴

Në tubimin e ceremonisë së betimit ishin mbledhur një numër i madh i qytetarëve të Lugut të Baranit dhe më gjerë. Fillimisht u përshëndeten oficerët dhe të pranishmit. Oficeri Rustem Tetaj e mbajti fjalimin e tij para ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më poshtë mund ta lexoni fjalimin e plotë të mbajtur në Baranë, më 20 korrik 1998.

“Në emër të eprorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u dëshirojë realizimin e synimeve tona në çlirimin e territoreve dhe hapësirave tona shqiptare. Ju pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që sot bëni betimin dhe zëri i juaj që jehonë në këto troje, është tmerr për armiku. Arma në duart tuaja është si rezultat i papajtueshmërisë ndaj armikut. Është vdekje për armikun, jehona e krismave të armëve të lirisë në Kosovën nënë. Vendosmëria dhe trimëria që gufon në gjokset rinore dhe në sytë tuaj është garanci e fitoreve tona. Në emër të Shtabit Operativ të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të Zonës Operative të Dukagjinit, uroj nga zemra juve dhe

¹⁴ Rustem Tetaj, Deklaratë dhen autorit, 20, gusht, 2007.

*eprorët tuaj, punë të mbarë, vigjilencë dhe gatishmëri të përbashkët çlirimtare për detyrat e shenjta të mbrojtjes së atdheut. Pushka e juaj u bëftë top kundër armikut, kjo tokë është e jona, kjo tokë i digjet nën këmbë armikut, fitorja është e jona”.*¹⁵Fjalimi i oficer Rrustem Tetaj u mirëprit me duartrokitje nga të pranishmit.

Para se të lexohet teksti i betimit, *“Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u rreshtuan dhe u raportua: Brigada është rreshtuar për ta bërë betimin solemn, raporton Esat Ademaj”.* Pas raportimit u këndua himni kombëtar i Shqipërisë. Teksti i betimit: *“Unë, ushtar i popullit tim, betohem në emër të atdheut dhe Kushtetutës, betohem përpara flamurit kombëtar, do të jemi të pathyer në luftën për çlirimin e Kosovës. Unë do të luftojë kundër tradhtarëve të vendit deri në pikën e fundit të gjakut tim. Do të jem ushtar i bindur dhe i disiplinuar, ne do t’i zbatojmë me përgjegjësi urdhëratë dhe detyrat e komandave eprorë, në ndihmën e luftës çlirimtare, ushtrisë dhe sekretit ushtarak, ne nuk e tradhtojmë gjakun e humbur se është gjaku im. Betohem!”.*¹⁶

Pas betimit, fjalën e mori komandanti i Brigadës, duke i uruar ushtarët për betimin e dhënë para prindërve, ushtarëve dhe eprorëve dhe para luftës së Baranit. Bëri apel që betimi i dhënë të jetësohet dhe të shkojë përpara në fitore deri në çlirimin e Kosovës, deri në pëllëmbën e fundit të Kosovës martire.¹⁷

Në këtë ngjarje të rëndësishme nuk mund të mungonte z. Ramush Haradinaj komandant i Zonës Operative të Dukagjinit, i cili ju drejtua

¹⁵ Arkivi i Brigadës 131 “Adrian Krasniqi” - Zona Operative e Dukagjinit, Baran, 1998, betimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kazermën e Baranit, 20 korrik 1998, DVD.

¹⁶ *Po aty.*

¹⁷ *Po aty.*

të pranishmëve. *“Përshëndetje ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, eprorë dhe të pranishëm. Jam i bindur dhe uroj që gjaku i djemve dhe i Adrianit dhe brigada e juaj, t’i jep dritë dhe të çlirohet çdo pëllëmbë e trojeve shqiptare, jo vetëm e Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës e ka filluar luftën e do ta çon deri në fund, deri në çlirimin e trojeve shqiptare dhe bashkimit kombëtar. Ky është qëllimi dhe kjo është lufta e jonë”*.¹⁸

Krejt në fund, të gjithë ushtarët u nënshkruan, dhe u pajisen me libreza që dëshmojnë se janë pjesëtarë të UÇK-së, në kazermën e Baranit. Të gjithë pa përjashtime ishin të emocionuar me mbylljen e ceremonisë së betimit.

Kazerma e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Baran, kishte rendësi të madhe për zhvillimin e luftës në Lugun e Baranit dhe më gjerë. Ishte unike për llojin e vet, jo vetëm në Zonën Operative të Dukagjinit, por edhe në zonat tjera operative në Kosovë. Kazerma kishte një staf të përgatitur profesionalisht me nivele të larta akademike, që e njihnin mirë artin ushtarak. Profesionalizimi i kësaj kazermë e mobilizoi në masë të madhe popullin e kësaj ane në luftën çlirimtare kundër pushtuesve serbë. Shumë të rinj u bënë pjesë e saj, sepse ishte vendi i duhet ku trajnoheshin dhe përgatiteshin në mënyrën profesionale, ashtu siç i ka hije një ushtrie të rregullt.

Ushtria Çlirimtare e Kosovë, me të gjitha kapacitetet e saj u mundua që të gjente mbështetje nga shtresat e gjera të popullit të Kosovës. Sepse, populli ishte i bindur se lufta duhet të zhvillohej deri në çlirimin e plotë të vendit nga pushtuesit serbë. Përveç organizimit të brendshëm, Ushtria Çlirimtare e Kosovës gëzoi përkrahjen edhe të faktorit ndërkombëtar, që ishte vendimtare për çlirimin e Kosovës.

¹⁸Po aty.

UÇK-ja dhe populli shqiptar i Kosovës u dëshmuan para faktorit ndërkombëtar se ishin të gatshëm të mbronin vendin e tyre deri në çlirimin e tij. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me mbështetjen e popullit e vuri në lëvizje edhe faktorin ndërkombëtar. Lufta e Kosovës u bë faktor në diplomacinë evropiane dhe botërore. Kosova gëzonte mbështetje ndërkombëtare nga fuqitë më të mëdha të botës, siç ishte NATO dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çlirimi i Kosovës në krye më UÇK-në, dhe me intervenimin e NATO-s, mbylli një epokë luftërash dhe sakrificash shekullore të popullit shqiptar të Kosovës.

